



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

BORDI

VENDIM

Nr. 59, Datë 02.04.2024

MBI

**NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 179, DATË 08.11.2017,  
“MBI CERTIFIKIMIN E SHOQËRISË “OPERATORI I KOMBINUAR I GAZIT  
NATYROR” ALBGAZ SH.A.”, I NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.04.2024, mbasi shqyrtoi relacionin nr.633/3 prot., datë 29.03.2024, të përgatitur nga Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes “Mbi një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017 “Mbi certifikimin e shoqërisë “Operatori i Kombinuar i Gazit Natyror” ALBGAZ sh.a.”, i ndryshuar”,

**Konstatohet se:**

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 354, datë 28.12.2022, ka vendosur të ndryshojë pikën 5.2, të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, duke i lënë kusht shoqërisë “ALBGAZ” sh.a. të marrë masa për të paraqitur në ERE brenda datës 20.11.2023 provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, nenet 11 dhe 46, pika 10, e ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.
- ERE nëpërmjet shkresës nr. 71 prot., datë 11.01.2023 njoftoi shoqërinë për vendimin e sipërcituar. Në vijim me shkresën me nr. 634 prot., datë 15.02.2024, drejtuar “ALBGAZ” sh.a., ERE i ka kërkuar shoqërisë që të depozitojë provat dokumentare për bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe neni 46, pika 10, të ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, pasi nga ana e shoqërisë nuk është depozituar dokumentacioni i kërkuar brenda afatit të përcaktuar, data 20.11.2023.
- Për kushtin e vendosur në pikën 5.2 të vendimit të bordit të ERE-s nr. 179/2017, i ndryshuar, që lidhet me bashkëpunimin ndër-institucional për realizimin e ndryshimeve në kuadrin ligjor, neni 11 dhe 46, pika 10, e ligjit nr. 102/2015 “Për Sektorin e Gazit Natyror”, i ndryshuar dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë, shoqëria “Albgaz”

sh.a. me shkresën nr. 634/1 prot., datë 21.02.2024, ka bërë me dije se për plotësimin e këtij kushti i është drejtuar zyrtarisht Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë dhe është në pritje të një përgjigje përfundimtare, gjë e cila është përtej vullnetit të saj. Në këto rrethana, shoqëria ka kërkuar shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri në datën 31.12.2024.

- Duke qenë se ky kusht mbetet ende pa plotësuar për shkaqe që nuk varen nga vullneti i shoqërisë “ALBGAZ” sh.a., dhe duke qenë se nga ana e shoqërisë janë bërë përpjekjet përkatëse për plotësimin e këtij kushti, vlerësohet që të merret në konsideratë kërkesa e saj për shtyrjen e afatit të plotësimit të këtij kushti deri më datë 31.12.2024.
- Në nenin 53, pika 2 e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë Kod, nëse ligji ose aktet nënligjore nuk parashikojnë një afat të caktuar për kryerjen e një veprimi procedural, organi publik që kryen procedurën cakton me vendim të veçantë një afat të arsyeshëm, sipas çështjes konkrete dhe në përputhje me parimin e ushtrimit të ligjshëm të diskrecionit.*

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

### **Vendosi:**

1. Pika 5.2 e vendimit të bordit të ERE-s nr. 179, datë 08.11.2017, i ndryshuar, bëhet si vijon:  
*5.2: Brenda datës 31.12.2024 shoqëria “ALBGAZ” sh.a. duhet të depozitojë në ERE realizimin e ndryshimeve në nenet 11 dhe 46, pika 10 ligjit nr. 102/2015 “Për sektorin e gazit natyror”, i ndryshuar, dhe transferimin e kompetencave tek Ministria e Financave dhe Ekonomisë.*
2. Ky vendim i shtrin efektet duke filluar nga data 21.11.2023.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 45 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

**KRYETARE NË DETYRË**

**Erjola SADUSHI**